

Durim ABDULLAHU

**BURIMET BIBLIOGRAFIKE PËR LUFTËN E KOSOVËS:
STATISTIKA, RAPORTE DHE DITARË LUFTE**

Abstrakt:

Ky artikull paraqet një studim bibliografik mbi literaturën librare të botimeve me tematikë luftën e Kosovës (1997-1999). Këtu është trajtuar në rrafshin e të dhënave statistikore pothuajse e tërë literatura botërore e librave të botuar që në çfarëdo aspekti apo niveli e kanë për subjekt luftën e Kosovës. Botimet e para të librave për luftën e Kosovës, kanë filluar të publikohen qysh në kohën kur po zhvillohej kjo luftë, ndërkohë gjatë periudhës 25-vjeçare pas përfundimit të kësaj lufte më 1999, numri i librave për këtë luftë është shumëfishuar në mënyrë eksponenciale. Deri në vitin 2024, nga autorë shqiptarë janë botuar mbi 600 libra për luftën e Kosovës, kurse autorë nga e gjithë bota kanë botuar mbi 7 000 libra të tjerë me tema nga lufta e Kosovës. Ky punim është rezultat i një studimi më të gjerë mbi burimet bibliografike për luftën e Kosovës, i realizuar nga hulumtime të kryera në 45 biblioteka në 43 shtete të botës. Ky korpus kaq i madh i librave të publikuar me tema nga lufta e Kosovës përbëhet nga një larushi zhanresh, si: ditarë lufte, reportazhe lufte, raporte organizatash ndërkombëtare, kujtime, analiza ushtarake, përmbledhje intervistash dhe historish gojore, botime me dokumente dhe fotografi, biografi luftëtarësh, studime etj. Por ky artikull është i përqendruar vetëm në dy kategori librash që përgjithësisht janë të ndërtuar mbi burime të dorës së parë të prodhuara qysh në kohën e luftës, gjegjësisht mbi raportet e organizatave të ndryshme dhe te

ditarët e luftës. Në këtë artikull janë listuar bibliotekat kombëtare dhe ndërkombëtare me numrin më të madh të librave për luftën në Kosovë; janë përmbledhur raportet më të rëndësishme apo më të referuara për luftën e Kosovës; si dhe janë kategorizuar disa nga ditarrët e luftës të botuar nga fletoret me shënime të mbajtura nga dëshmitarë dhe personalitete të ndryshme gjatë kohës që po zhvillohej lufta në Kosovë.

Fjalët kyçe: *Lufta e Kosovës, libra, biblioteka, statistika, raporte, ditarrë lufte.*

Parashtrime dhe statistika

Nga tërë historia e popullit shqiptar, lufta e Kosovës e zhvilluar mes viteve 1997 dhe 1999, është ngjarja apo periudha historike për të cilën janë shkruar më së shumti libra. Kështu në të gjitha etapat e historisë së shqiptarëve, nuk ka një ngjarje apo epokë që ka tërhequr më shumë vëmendjen e botës dhe që ka prodhuar më shumë tekst se sa lufta e Kosovës (1997-1999). Kjo e tejkalon ku e ku edhe interesimin gjithashtu të madh për trashëgiminë e pamatë të komunizmit në Shqipëri. Ky përfundim sikurse edhe i tërë ky artikull i referohet një studimi të kryer viteve të fundit, pikërisht në prag të përmbushjes së 25-vjetorit të parë të kaluar nga lufta e Kosovës. I realizuar nga autori i këtij artikulli dhe studiuesja Davjola Ndoja gjatë vitit 2023 dhe gjysmës së parë të vitit 2024, nga ky studim doli një libër që u publikua në Prishtinë më 14 qershor 2024, me titull: “*Lufta e Kosovës 1997-1999: Një bibliografi e përzgjedhur*”.¹ Ky studim është realizuar nëpër 45 biblioteka në 43 shtete të ndryshme duke iu qasur atyre kryesisht përmes katalogëve online. Rezultati: mbi 7 700 libra janë botuar deri sot për luftën në Kosovë, të shkruar apo të përkthyer në 28 gjuhë të ndryshme. Kjo shifër tregon për një korpus bibliografik tejet të madh të librave të botuar me tematika të

¹ Durim Abdullahu, Davjola Ndoja, *Lufta e Kosovës 1997-1999: Një bibliografi e përzgjedhur*, Prishtinë: Biblioteka Kombëtare e Kosovës, 2024.

llojllojshme nga lufta e Kosovës, duke llogaritur këtu vetëm librat, meqë në këtë studim nuk janë përfshirë artikujt shkencorë, tezat e doktoratës dhe të masterit, por vetëm veprat e botuara në format libri.

Katër luftërat që e shpërbënë Jugosllavinë mes viteve 1990 dhe 1999, ishin luftërat e para dhe të fundit në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore, në shekullin XX. Lufta e Kosovës, ishte lufta e katërt dhe e fundit ndër luftërat në Jugosllavi,² pas luftërave në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë. Duke filluar nga pesë javët e fundit të vitit 1997 deri në mes të qershorit të vitit 1999, një luftë e përqendruar në krahinën e Kosovës, e përfshiu gjatë tre muajve të fundit të saj pothuajse gjithë çfarë kishte mbetur nga Jugosllavia atë kohë, gjegjësisht Serbinë dhe Malin e Zi. Gjatë pranverës së vitit 1999, pamjet televizive të masakrave ndaj civilëve shqiptarë dhe spastrimi etnik i Kosovës përmes dëbimit të shqiptarëve prej andej nga policët dhe ushtarët serbë e jugosllavë, si dhe veçanërisht gjatë fushatës bombarduese 78-ditore të 19 shteteve të Aleancës së NATO-s mbi Jugosllavi, emri “Kosovë” u bë një fjalë shumë e përmendur në mediat më të njohura botërore.

Në ato pak ditë pra, nga një vend gati krejtësisht i panjohur në Evropë, Kosova u bë një emër vendi i njohur jo vetëm për evropianët por edhe për amerikanët. Aq shumë ka ngelur e lidhur me atë kohë dhe me luftën emri i Kosovës, sa që edhe një çerekshekulli pas, me gjithë zhvillimet e shumta ndër vite, emri i Kosovës vazhdon të asociohet në publikun perëndimor më së shumti me luftën e asaj kohe. Deri në prag të luftës, emri “Kosovë” përveç si një emërvend ishte krejt i panjohur në Evropë. Megjithëse pjesë e kontinentit evropian, “Kosova” e shumta mund të njihej si një term gjeografik, pasi ky emër nuk figuronte fare në hartat politike të Evropës. Përkundër subjektivitetit të saj shtetëror në kuadër të Federatës së Jugosllavisë, si Krahina Socialiste Autonome e Kosovës mes viteve 1974 dhe 1989, Kosova nuk arriti të bëhej republika e shtatë jugosllave, duke ngelur

² Tricia Andryszewski, *Kosovo: The Splintering of Yugoslavia*, Brookfield, Connecticut: The Millbrook Press, 2000.

kështu fare pak e njohur në rrafshin ndërkombëtar.³ Madje, në gjysmën e dytë të shek. XX, Kosova duhet të ketë qenë një nga vendet më të izoluara dhe më të prapambetura në tërë Evropën. Aq pak dihej për Kosovën, sa që kur shtetet evropiane dhe ato botërore u përballën me çështjen e saj dhe konfliktet për të, ato e patën të vështirë në disa raste të mbajnë qëndrime ndaj një vendi për të cilin kishin aq pak informacione.

Ky terr informativ, u ndriçua fillimisht nga libri i një historiani anglez, që u botua më 1998 dhe i cili nga atëherë ka ngelur libri më i referuar për historinë e Kosovës. *Kosova: një histori e shkurtër*,⁴ ishte një vepër e dalë nga një studim trevjeçar prej ekspertit të Ballkanit, Noel Malcolm, në të cilën ai e kishte sintetizuar historinë e Kosovës që nga antika, përgjatë periudhës mesjetare, epokës osmane dhe deri në kohën kur u shkrua libri. Kopje të këtij libri, u qarkulluan gjithandej nëpër kancelari shtetërore, kabinete ministrore dhe zyre vendimmarrëse. Pas përfundimit të luftës së Kosovës, libri i Malcolmit, *Kosova: një histori e shkurtër*⁵ u përkthye dhe u botua në shqip më 2001 dhe prej atëherë ka parë shumë ribotime në gjuhën shqipe. Por ai asnjëherë deri sot nuk është botuar në serbisht, madje, më 8 tetor 1999, një grup historianësh dhe akademikësh serbë në Institutin e Historisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, e organizoi një diskutim për t'i kundërshtuar tezat e këtij libri, prej të cilit në vitin 2000, doli libri *Përgjigje Noel Malcolmit, Kosova: një histori e shkurtër*.⁶

Që nga vitet '90-të dhe deri sivjet më 2024, lufta e Kosovës dhe kontekstet e saj ishin subjekte interesimi dhe tema studimi për

³ Mary Motes, *Kosova: Preludi i luftës 1966-1999*, përkth. A. Morina, Prishtinë: Alter Habitus, 2017.

⁴ Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History*, London: Macmillan, 1998.

⁵ Noel Malcolm, *Kosova: një histori e shkurtër*, përkth., A. Karjakdiu, Prishtinë: KOHA, 2001.

⁶ Slavenko Terzic, (edit.), *Response to Noel Malcolm's book Kosovo: A Short History*, Bleggrade: Institute of History of the Serbian Academy of Sciences and Arts, 2000.

mijëra studiues, akademikë, historianë, sociologë, gazetarë dhe autorë profilesh të ndryshme në tërë botën.

Fakti që literatura e librave për luftën e Kosovës është botuar në të paktën 28 gjuhë të ndryshme, tregon shtrirjen e gjerë të historisë së saj në diskurset e botimeve ndërkombëtare. Tutje janë renditur shtatëmbëdhjetë biblioteka kombëtare dhe një e veçantë që kanë më së shumti libra me temë ngjarjet e luftës në Kosovë. Biblioteka e Kongresit Amerikan, rezulton të jetë biblioteka me më së shumti libra për luftën e Kosovës, gjithsej 1 122 libra. Për shkak që shumë gjykata ndërkombëtare janë në Hagë të Holandës dhe veçanërisht shkaku i të qenit qendër e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, biblioteka e dytë për nga numri i librave që ka për luftën në Kosovë, është Biblioteka e Ligjit Ndërkombëtar në Hagë, që numëron 1 013 tituj. Biblioteka e tretë me më shumë libra për luftën e Kosovës në botë është Biblioteka Kombëtare e Austrisë, në të cilën janë evidentuar 918 libra me këtë temë. Ajo pasohet sipas numrit të librave për luftën në Kosovë, nga Biblioteka Britanike me 861 tituj; pastaj nga Biblioteka Kombëtare e Danimarkës me 633 libra; Biblioteka Kombëtare e Gjermanisë me 631 libra; Biblioteka Kombëtare e Suedisë me 523 libra; Biblioteka Kombëtare e Serbisë me 412 libra; Biblioteka Kombëtare e Zvicrës me 345 libra; Biblioteka Kombëtare e Kroacisë me 334 libra; Biblioteka Kombëtare e Japonisë me 225 libra; Biblioteka Kombëtare e Francës me 207 libra; Biblioteka Kombëtare e Australisë me 203 libra; Biblioteka Kombëtare e Italisë me 202 libra; Biblioteka Kombëtare e Norvegjisë me 200 libra; Biblioteka Kombëtare e Finlandës me 198 libra; Biblioteka Kombëtare e Greqisë me 105 libra dhe Biblioteka Shtetërore e Rosisë me 105 libra gjithashtu.⁷ Katalogët e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë nuk pasqyrojnë tërësinë e librave të botuar në shqip për luftën e Kosovës, pasi shumë botime nuk janë arkivuar fare dhe kurrë në këto biblioteka. Megjithatë, që nga viti 2019 e tutje, autori i këtij artikulli ndërmori një projekt personal për

⁷ Durim Abdullahu, *Lufta e Kosovës ...*, 7-8.

ngritjen e një koleksioni librar privat me libra me tematikë luftën e Kosovës, i cili deri sot, ka rezultuar me një koleksion privat librash prej mbi 600 titujsh për luftën e Kosovës në shqip. Nga e tëra kjo, mund të përfundohet që gjuhët në të cilat janë botuar më së shumti libra për luftën e Kosovës janë anglishtja, gjermanishtja, shqipja dhe serbishtja. Gjatë këtyre më shumë se 25 vjetësh, më së shumti libra për luftën e Kosovës janë botuar qysh në vitet e kësaj lufte: më 1997, janë botuar 77 libra; më 1998, janë botuar 205 libra dhe më 1999 janë botuar plot 900 libra për luftën e Kosovës.⁸

Raporte dhe regjistra

Botimet më të hershme për luftën e Kosovës, janë ata lloj librash të botuar nga materialet e prodhuara qysh gjatë kohës së luftës dhe në radhë të parë, *raportet e organizatave ndërkombëtare*. I pari raport i tillë për luftën e Kosovës është botuar në shkurt të vitit 1999, nga organizata ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, Human Rights Watch, me titull *Një javë terrori në Drenicë: shkeljet e së drejtës humanitare në Kosovë*.⁹ Ky raport është shkruar nga Peter Bouckaert dhe është redaktuar nga Fred Abrahams, të dy këta kërkues të Human Rights Watch, që hulumtuan në terren në Kosovë mes shtatorit dhe dhjetorit të vitit 1998 për shkeljet e të drejtave të njeriut.

Pak muaj më pas, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë apo OSBE/OSCE, e botoi një raport të përgatitur prej kësaj organizate ndërqeveritare, si një raport i dalë nga Misioni Verifikues i OSBE-së në Kosovë. Ky raport i botuar në dy vëllime në Varshavë të Polonisë, është titulluar *Kosovo/Kosova: siç u pa, siç u tha: një analizë e gjetjeve të të drejtave të njeriut të Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë nga tetori 1998 deri në qershor 1999*.¹⁰ Siç

⁸ Po aty, 13.

⁹ Peter Bouckaert, *A Week of Terror In Drenica: Humanitarian Law Violations in Kosovo*, New York: Human Rights Watch, 1999, 2.

¹⁰ OSCE, *Kosovo/Kosova: As seen, as told - An analysis of the human rights findings of the OSCE Kosovo Verification Mission from October 1998 to June 1999*,

kuptohet qartësisht nga titulli i këtij raporti, ai është një analizë e prodhuar nga gjetjet e të drejtave të njeriut prej Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë, mision ky i cili verifikoi respektimin e armëpushimit në njërën anë dhe shkeljet e të drejtave të njeriut në anën tjetër në Kosovë, nga tetori i vitit 1998 deri në qershor të vitit 1999.

Në shkurt të vitit 2000, agjencia e Kombeve të Bashkuara, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), e botoi një raport për krizën e refugjatëve të shkaktuar nga lufta në Kosovë. Mbrapa titullit *Kriza e refugjatëve në Kosovë: një vlerësim i pavarur i gatishmërisë dhe reagimit emergjent të UNHCR-së*,¹¹ është një raport i hartuar nga katër hulumtues të pavarur: Astri Suhrke, Michael Barutciski, Peta Sandison dhe Rick Garlock. Që nga atëherë, për shkak të natyrës specifike të burimeve të drejtpërdrejta nga të cilat është hartuar dhe kredibiliteti i organizatës gjegjëse, ky raport i UNHCR-së, është raporti më i rëndësishëm për refugjatët e luftës së Kosovës.

Po në vitin 2000, u botua edhe një tjetër raport për luftën e Kosovës, me një karakter më gjithëpërfshirës dhe i vlerësuar si ndër më të besueshmit e kësaj kategorie. Ai është *Raporti i Kosovës: konflikti, përgjigjja ndërkombëtare dhe mësimet e mësuara*,¹² i shkruar nga 11 autorë, ekspertë fushash të ndryshme, anëtarë të Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar mbi Kosovën, i cili ishte themeluar nga një nismë e kryeministrit të Suedisë, Göran Persson, e miratuar nga Sekretari i OKB-së, Kofi Annan. Ky është një nga librat më të rëndësishëm dhe më serioz për luftën në Kosovë, mbrapa të cilit ka një histori të veçantë se si është shkruar. Më 6 gusht 1999, dy muaj

volume 1 - 2, Varshavë: Organization for Security and Co-operation in Europe, 1999.

¹¹ United Nations High Commissioner for Refugees Evaluation and Policy Analysis Unit, *The Kosovo refugee crisis: An independent evaluation UNHCR's emergency preparedness and response*, Gjenevë: UNHCR, 2000.

¹² Independent International Commission on Kosovo, *Kosovo Report: Conflict, International Response, Lessons Learned*, Oxford: Oxford University Press, 2000.

pas përfundimit të luftës në Kosovë, kryeministri Persson e njoftoi publikun me themelimin e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar mbi Kosovën. Qeveria suedeze i ftoi për kryetar dhe bashkëkryetar të këtij komisioni, gjyqtarin Richard Goldstone nga Afrika e Jugut dhe Carl Tham, Sekretarin e Përgjithshëm të Qendrës Ndërkombëtare, Olof Palme, në Stokholm. Në bazë të ekspertizave të tyre, gjinisë dhe shtrirjes gjeografike, në komision u zgjodhën 11 anëtarë: dr. Hanan Ashwari nga Palestina, profesor Grace d'Almedia nga Benini, senatori Akiko Domoto nga Japonia, profesor Richard Falk nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ambasadori Oleg Grinevsky nga Rusia, Miachael Ignatieff nga Kanadaja, profesor Mary Kaldor nga Mbretëria e Bashkuar, profesor Martha Minow nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, profesor Jacques Rupnik nga Franca, Theo Summer nga Gjermania dhe Jan Urban nga Republika Çeke. Gjatë periudhës njëvjeçare sa ishin emëruar, anëtarët e këtij komisioni u takuan pesë herë: në Stokholm (21 shtator 1999), në Nju-Jork (5-6 dhjetor), Budapest (5-6 prill 2000), në Firence (26-30 qershor), në Johaneshberg (27-28 gusht 2000).

Dy delegacione të këtij komisioni e vizituan Kosovën dhe u takuan me shqiptarë dhe serbë, pjesëmarrës dhe dëshmitarë të luftës. Anëtarë të komisionit u takuan edhe me përfaqësues të disa shteteve të NATO-s, ndërsa u refuzuan nga autoritetet e Serbisë, që e paragjykuan punën e tij duke e cilësuar paraprakisht si me pretendime antiserbe. *Raporti i Kosovës* përbëhet nga tri pjesë dhe nga dhjetë anekse. E titulluar “Çfarë ndodhi?”, pjesa e parë ka katër kapituj për origjinën e krizës së Kosovës; konfliktin e armatosur nga shkurti 1998 deri në mars 1999; mbikëqyrjen ndërkombëtare të luftës dhe Kosovën nën sundimin e Kombeve të Bashkuara.

Pjesa e dytë përbëhet nga analiza të strukturuar në pesë kapituj për dimensionin diplomatik; të drejtën ndërkombëtare dhe intervenimin humanitar; organizatat ndërkombëtare dhe rolin e mediave; dimensionin rajonal dhe statusin e Kosovës. Pjesa e tretë përbëhet nga konkluzionet dhe komentet. Në fund, raporti është

shoqëruar nga dhjetë shtojca mes të cilave edhe Marrëveshja e Rambujesë dhe Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara.

Rreth një vit më pas, kur kishin kaluar dy vjet nga përfundimi i luftës në Kosovë, organizata Human Rights Watch e botoi fillimisht në anglisht dhe një vjet më pas edhe në shqip raportin e mirënjohur për krimet e luftës në Kosovë: *Under Orders: War Crimes in Kosovo*,¹³ apo siç është përkthyer në shqip më 2002, *Nën pushtetin e urdhrave: krimet e luftës në Kosovë*.¹⁴ Ky libër është mbase libri më i cituar për luftën e Kosovës dhe jo vetëm për krimet e kryera gjatë kësaj lufte. Në një vëllim prej mbi 600 faqesh, dhjetëra kërkues të organizatës Human Rights Watch, i kanë strukturuar hulumtimet e tyre në terren për krimet e luftës në bazë të komunave në Kosovë, duke u bazuar në provat e gjetura në terren dhe në dëshmitë e dëshmitarëve.

Mes botimeve të ngjashme për krimet e luftës, masakrat dhe vrasjet gjatë luftës në Kosovë, ka të paktën edhe dy libra kapitalë. I pari është një libër i vëllimshëm me mbi 1 000 faqe, *Krimet e luftës në Kosovë 1998-1999, Monografi*, i hartuar dhe i botuar në vitin 2010 nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë (KMDL NJ). Sadoqë i ngelur i paplotë si projekt, meqë ky vëllim i parë nuk është pasuar më nga ndonjë vëllim tjetër, te ky libër janë botuar dëshmi për vrasjet dhe masakrat ndër krimet e luftës në Kosovë, të strukturuar edhe përmes statistikash e grafikonesh në bazë të komunave.¹⁵ Libri tjetër i po kësaj natyre dhe gjithashtu ende i pakompletuar si projekt, mbanë autorësinë e dy degëve të një organizate, Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe Fondi për të Drejtën Humanitare Serbi. *Libër - Kujtimi i Kosovës 1998-2000*, është një botim tregjuhësh (shqip, serbisht dhe anglisht), në të cilin janë

¹³ Human Rights Watch, *Under Orders: War Crimes in Kosovo*, New York: Human Rights Watch, 2001.

¹⁴ Human Rights Watch, *Nën pushtetin e urdhrave: krimet e luftës në Kosovë*, përkth., M. Nano, V. Muçi, Tiranë: Korbi, 2002.

¹⁵ Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, *Krimet e luftës në Kosovë 1998-1999*, Monografi, Prishtinë: KMLDNJ, 2010.

listuar profilet e 13 535 njerëzve të vrarë gjatë luftës në Kosovë dhe pas saj, nga vitit 1998 deri në fillim të vitit 2000.¹⁶ Deri sot, ky libër paraqet databazën më të referuar dhe të cilësuar si më të besueshmen për të gjithë të vrarët dhe të zhdukurit me dhunë gjatë luftës së Kosovës.

Ditarë lufte

Siç ka ndodhur rëndom edhe gjatë luftërash të tjera, mes librave të dalë nga materiale burimore të kohës së luftës, ka edhe ditarë lufte, pra blloqe shënimesh apo fletore me shënime të mbajtura gjatë luftës nga njerëz që ndodheshin në rrethana dhe pozicione të ndryshme në kohën e luftës. Deri sot, janë botuar mbi tridhjetë ditarë të mbajtur gjatë luftës në Kosovë, por nga hulumtime dhe burime të ndryshme, rezulton që ka edhe jo pak ditarë lufte nga koha e luftës në Kosovë që kanë ngelur në dorëshkrim dhe që nuk janë botuar ende. Ditari i parë i kohës së luftës në Kosovë që u botua, është ditari i historianit dhe aktivistit Zekeria Cana, që u botua veç pak kohë pas saj, për çka mund të kuptohet edhe nga titulli i tij, *Ditari i luftës*.¹⁷ Siç kuptohet, Cana e kishte zakon edhe më herët të mbante ditar, sepse vetëm një vjet më pas, ai e ribotoi këtë ditar si vëllim të dytë që e pasonte një vëllim të parë me shënimet e tij të dekadës së fundit të paraluftës: *Ditari i robërisë (1) tetor 1989-qershor 1998*,¹⁸ dhe *Ditari i robërisë (2) 1 korrik 1998-23 mars 1999*.¹⁹

Pothuajse në të njëjtën kohë, në Tiranë u botua ditari i mbajtur gjatë kohës së luftës në Kosovë, nga shkrimtari më i shquar shqiptar, Ismail Kadare. Megjithëse autori i tij nuk ishte në Kosovë, por në

¹⁶ Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, *Libër - kujtimi i Kosovës 1998-2000*, Prishtinë: Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, 2011.

¹⁷ Zekeria Cana, *Ditari i luftës*, Prishtinë: Zëri, 1999.

¹⁸ Zekeria Cana, *Ditari i robërisë 1 - tetor 1989 - qershor 1998*, Prishtinë: Rozafa, 2000.

¹⁹ Zekeria Cana, *Ditari i robërisë 2 - korrik 1998 - 23 mars 1999*, Prishtinë: Rozafa, 2000.

banesën e tij në Paris, ditari *Ra ky mort e u pamë*²⁰ sjellë një kronologji ngjarjesh nga lufta e Kosovës, rrëfyer bashkë me pikëpamjet plot shqetësim të shkrimtarit atë kohë aq të angazhuar, Ismail Kadare.

Një vepër e tërë prej ditarësh të mbajtur për mbi tri dekada dhe e botuar në disa vëllime, është vepra e shkrimtarit dhe historianit të letërsisë, Rexhep Qosja, *Dëshmitar në kohë historike*. Prej kësaj vepre monumentale, dy vëllime, gjegjësisht vëllimi i VII²¹ dhe vëllimi i VIII²² përmbajnë shënimet e Rexhep Qosjes gjatë viteve të luftës në Kosovë. Një pjesë e këtij ditari, konkretisht shënimet e mbajtura nga Qosja gjatë bisedimeve në Konferencën e Rambujesë dhe në Paris, janë botuar që më 1999 si ditar i ndarë më vete: *Paqja e përgjakshme: Konferenca ndërkombëtare për Kosovën (Rambuje 6 - 23.02.1999 dhe Paris 14 - 19.03.1999)*.²³

Në rrethana krejtësisht të tjera, i ndodhur në Beograd teksa kryeqyteti i Jugosllavisë po bombardohet nga avionët e NATO-s, gazetari Fahri Musliu po mbante ditar gjithashtu. I botuar më pas me titullin *Ditari i gazetarit shqiptar në Beograd (janar-qershor 1999)*, ky ditar lufte është shumë i veçantë edhe sepse përcjellë perspektivën nga ana tjetër, përkatësisht atë të një shqiptari të ndodhur në mes të Serbisë, kur lufta e Kosovës e përfshiu dhe e dogji edhe atë vetë gjatë fushatës ajrore të NATO-s mbi Jugosllavi.²⁴

Vlera më e madhe e ditarëve të luftës, qëndron te të qenit burime bashkëkohore që kanë fiksuar dëshmi të shkruara nga vëzhgime dhe dëshmi tejet personale për zhvillime dhe ngjarje të

²⁰ Ismail Kadare, *Ra ky mort e u pamë*, Tiranë: Onufri, 1999.

²¹ Rexhep Qosja, *Dëshmitar në kohë historike (1990-1998)*, Ditar VII, Tiranë: Botime Toena, 2016.

²² Rexhep Qosja, *Dëshmitar në kohë historike (1999-2000)*, Ditar VIII, Tiranë: Botime Toena, 2019.

²³ Rexhep Qosja, *Paqja e përgjakshme: Konferenca ndërkombëtare për Kosovën (Rambuje 6 - 23.02.1999 dhe Paris 14 - 19.03.1999)*, Tiranë: Botimet Toena, 1999.

²⁴ Fahri Musliu, *Ditari i gazetarit shqiptar në Beograd (janar-qershor 1999)*, Prizren: Altera, 2023.

veçanta, shpeshherë të kufizuara në rrethe krejt të vogla, që ndryshe nuk do të ishin regjistruar askund tjetër jashtë kujtesës së njerëzve.

Këtej, ditarët e mbajtur në kohë lufte janë burime historie prej të cilëve mund të gjurmohen edhe fate personale dhe mikrohistoritë e përditshmërisë së jetëve njerëzore gjatë kohës së luftës në Kosovë. Të tillë janë edhe ditarë të tjerë me shënime nga koha e luftës në Kosovë, sikur ditari dy vëllimesh i doktoreshës aktiviste, Teuta Hadri, *Krimi që pashë me sytë e mi - një mjeke në luftë*.²⁵ Pastaj ditari faqepak i një vajze nëntëvjeçare nga Ferizaj, Rreze Abdullahut - e cila për nga ngjashmëria e rastit është krahasuar me Anna Frankun, - i botuar me një titull deklarativ *Nuk du luftë: ditari i nëntëvjeçares nga Ferizaj, Kosovë, në pranverën e vitit 1999*.²⁶ Ditarët e luftës së Kosovës janë mbajtur nga aktiviste si në rastin e Sevdije Ahmetit,²⁷ Mirela Oktrovas në kampet e refugjatëve në Maqedoni,²⁸ apo të Hanëmshahe Ilazit nëpër Drenicë;²⁹ nga gazetarë sikur Petrit Palushi³⁰ dhe Bashkim Shala në Kukës;³¹ ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si Januz Januzaj³² në Dukagjin, Hajrush Kurtaj në Nerodime³³ apo Ramadan Ibrahimimi në Llap etj.;³⁴ si dhe ditarë me autorë dëshmitarë rastësorë që kanë arritur të mbajnë ditarë lufte në rrethanat e kohës si Izet Abdyli

²⁵ Teuta Hadri, *Krimi që pashë me sytë e mi - 1 - Një mjeke në luftë. Ditar lufte viti 1998; Krimi që pashë me sytë e mi - 2 - Një mjeke në luftë. Ditar lufte viti 1999*, Tiranë: Botimet Dudaj, 2016.

²⁶ Rreze Abdullahu, *Nuk du luftë: ditari i nëntëvjeçares nga Ferizaj, Kosovë, në pranverën e vitit 1999*, Tiranë: Ombra GVG, 2014.

²⁷ Sevdije Ahmeti, *Ditari i një gruaje të Kosovës (shkurt 1998-mars 1999) Lufta përpara luftës*, përkth., Urim Nerguti, Prishtinë: Buzuku, 2019.

²⁸ Mirela Oktrova, *55 ditë*, Tiranë: Onufri, 2019.

²⁹ Hanëmshahe Ilazi, *Drenicë jemi me ty (Ditar)*, Prishtinë: autorja, 2007.

³⁰ Petrit Palushi, *Kukësi në 70 ditë - Pranverë '99*, Tiranë: Ombra GVG, 2019.

³¹ Bashkim Shala, *Kronikë lufte e qytetit pa luftë (Kukës '99)*, Prizren: Pena, 2019.

³² Januz Januzaj, *Në rrugën e lirisë (Ditar lufte)*, Prishtinë: NI "Merxhan Avdyli, 2011.

³³ Hajrush Kurtaj, *Në rrugën e lirisë (Ditar lufte: fakte, kujtime, dokumente)*, Prishtinë: Qendra, 2012.

³⁴ Ramadan Ibrahimimi, *Kur të gjitha rrugët shpinin në Zllash (Ditar lufte)*, Prishtinë: autori, 2011.

në malet e Drenicës,³⁵ Muhamet Mjeku i izoluar në Prishtinë,³⁶ apo Sokol Qerimi që qëndroi i strehuar në tavan rreth tre muaj.³⁷

Nga titujt e përzgjedhur për botim dhe nga ditët gjatë të cilave janë mbajtur shumica e shënimeve nëpër fletore e blloqe gjatë luftës, vërehet që periudha kohore kur më së shumti janë mbushur ditarët e luftës me shënime janë 78 ditët gjatë të cilave forcat aleate të paktit NATO, ndërmorën një fushatë bombardimesh mbi Jugosllavi. Kjo mund të shpjegohet edhe me faktin që pikërisht gjatë këtyre ditëve që përkojnë saktësisht me stinën e pranverës së vitit 1999, janë kryer masakrat dhe krimet më të mëdha të luftës në Kosovës, si dhe kur në rrethana të veçanta, shumë njerëz kanë jetuar të fshehur, të strehuar apo të izoluar, nga frika, rreziqet e shumëfishta dhe pamundësia për të lëvizur. Nga këtej, natyrshëm, fjalët “ankth” dhe “shpresë” janë të kudondodhura dhe të mbipërdorura në ditarët e luftës. Isa Hyseni e ka titulluar ditarin e tij të luftës pikërisht *Jeta në ankth: ditar lufte*,³⁸ siç ka bërë edhe Esat Avdyli me ditarin e vet të mbajtur gjatë luftës, që kur e ka botuar në vitin 2020, ia ka vënë titullin *Ankth dhe shpresë: ditar lufte*.³⁹ Po këto fjalë gjenden edhe në titullin e ditarit të luftës të mbajtur pikërisht gjatë bombardimeve të NATO-s, nga Imri Musliu, *78 ditë ankth dhe shpresë (ditar)*.⁴⁰

Duke u bazuar në numrin kaq të madh të librave për luftën e Kosovës, prej mbi 7 700 librash, për më tepër të shkruar dhe/apo të përkthyer në 28 gjuhë të ndryshme dhe të shpërndara në mbi 40 biblioteka në katër kontinente të botës, kuptohet që historia e luftës në Kosovë, është ngjarja apo periudha historike më e njohur botërisht në historinë e shqiptarëve dhe për të cilën është prodhuar më së shumti tekst. Nga të gjithë librat e botuar kudo dhe kurdo me tematika nga

³⁵ Izet Abdyli, *Në mes jetës dhe vdekjes: fletëza ditari lufte*, Prishtinë: Rozafa, 2008.

³⁶ Muhamet Mjeku, *Nga larg dhe afër (Ditar lufte)*, Prishtinë: Drita Press, 2023.

³⁷ Sokol Qerimi, *Ditët e mbijetesës në tavan (24 mars-19 qershor 1999)*, Prishtinë: Artini, 2024.

³⁸ Isa Hyseni, *Jeta në ankth: ditar lufte*, Gjilan: autori, 2004.

³⁹ Esat Avdylli, *Ankth dhe shpresë: ditar lufte*, Prishtinë: OM, 2020.

⁴⁰ Imri Musliu, *78 ditë ankth dhe shpresë (ditar)*, Prishtinë: autori, 2022.

lufta e Kosovës, rreth 8 % e tyre janë shkruar nga autorë shqiptarë dhe rreth 1/12 e këtyre librave janë shkruar në shqip. Anglishtja, gjermanishtja, shqipja dhe serbishtja janë gjuhët në të cilat janë shkruar dhe botuar më shumë libra me subjekt aspekte të ndryshme nga lufta e Kosovës.

Raportet e organizatave ndërkombëtare që kryesisht janë botuar nga organizata për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, janë librat më të referuar botërisht jo vetëm në hulumtime shkencore, por edhe në diskutet politike dhe diplomatike ndërkombëtare. Megjithëse lufta e Kosovës e ka shkaktuar një nga krizat më të mëdha të refugjatëve në një vend në raport me numrin e banorëve, jo pak njerëz kanë arritur të mbajnë shënime nëpër fletore dhe blloqe në kohë lufte, shumë prej të cilëve janë botuar ndër vite si ditarë lufte. Nga të gjitha kategoritë tekstuale të librave për luftën në Kosovë, ditarët e luftës janë kategoria librare që përmbajnë burimet më të drejtpërdrejta bashkëkohore nga koha e luftës në Kosovë. Por, ditarët e luftës ende nuk janë përfshirë mes burimeve historike ndër studimet e kryera nga studiuesit shqiptarë për luftën në Kosovë. Megjithëse kanë kaluar 25 vjet nga përfundimi i luftës, ende nuk mund të flitet mirëfilli për një historiografi të luftës së Kosovës në shqip, të prodhuara nga institucionet historiografike në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Mirëpo, në këtë momentum kalendarik, gjysmëshekulli nga lufta e Kosovës, duket sikur parakushti i distancës kohore është duke i bërë kohë themelimit të historiografisë për luftën e Kosovës (1997-1999) dhe botimeve mbi të. Ky vëllim, është një nga ta.